

GJËRAT E  
FUNDIT TË  
NJERIUT  
(PËRMIBLEDHJE)





## Çfarë janë gjërat e fundit të njeriut?


- Gjërat e fundit të njeriut janë gjërat e fundit me të cilat njeriu përballet kur mbaron jeta e tij.
- Gjërat e fundit të njeriut në latinisht quhen *novissima* (që do të thotë “gjëra të fundit”), kurse në greqisht *éschata*. Nga kjo fjalë greke vjen edhe termi tjetër “eskatologji”, që është doktrina që studion fatin, fundin e njeriut.
- **Gjërat e fundit të njeriut, sipas fesë katolike, janë 4:**
  1. Vdekja
  2. Gjyqi
  3. Ferri
  4. Parajsa



VDEKJA

# *Këndvështrimi ynë...*

- *Ne nuk mund ta kuptojmë vdekjen, dmth fundin e jetës sonë, pa patur të qartë përpara fillimin e jetës, dmth ngjizjen tonë dhe mbi të gjitha identitetin tonë: pra kush jemi, nga ku vijmë, si jemi të «gatuar», si jemi të ndërtuar.*
- *Duke u nisur nga ky këndvështrim mund të themi që:*





# Trupi i njeriut

---

- **Qenia njerëzore është e përbërë nga dy elemente: shpirti dhe trupi, që janë në unitet midis tyre.**
- **Trupi është një realitet material.**
- Sytë tonë janë të krijuar të tillë që mund të shohin vetëm realitetet që i përkasin botës materiale, prandaj ne mund ta shohim e ta prekim trupin tonë.
- Trupi i secilit prej nesh e ka origjinën në zigotë, qeliza e parë e njeriut, e përbërë nga gametet mashkullore dhe femërore. Pra, babai dhe nëna jonë biologjike japin gametet e tyre dhe gjatë ngjizjes, kemi fekondimin e vezës nga ana e spermatozoit.

## SHPIRTI I NJERIUT

- **SHPIRTI ËSHTË PRINCIPI JETËSOR I TRUPIT, AI QË I JEP JETË TRUPIT.**
- Tema e ekzistencës së shpirtit nuk i përket fesë, por bën pjesë në ato që quhen “gjërat që paraprijnë fenë (*praebulum fidei* në latinisht)”.
- Kjo sepse përfundimi që njeriu ka një shpirt mund të arrihet nëpërmjet arsyes, pa patur nevojë që të kemi fenë, ashtu sikur e ka arritur psh. filozofi pagan Aristoteli, duke vështruar një kufomë.
- Shpirti i njeriut krijohet nga Zoti.
- Zoti e krijon shpirtin e njeriut nga hiçi.
- **Zoti e krijon shpirtin e njeriut në çastin e ngjizjes**, pra në momentin që veza fekondohet nga spermatozoi dhe formohet zigota, qeliza e parë e një qenieje njerëzore
- Fuqitë, ose fakultetet, e shpirtit janë inteligjenca dhe vullneti.

Inteligjencën e ka çdo qenie njerëzore dhe është fuqia e shpirtit me anë të së cilës njeriu arsyeton (truri është elementi material, që mbledh informacionet dhe imazhet, por nuk është ai që vë në vepër arsyetimin).



## Shpirti është shpirtëror dhe I pavdekshëm

- **Njeriu është krijuar nga Zoti jo për vdekjen, por për jetën.** Trupi dhe shpirti, që janë në një unitet, një njësi e vetme pra, janë krijuar nga Zoti për të mos vdekur kurrë.
- Anima (lat.) pra shpirti është shpirtëror sepse e tejkalon, kalon përtej (thuhet me termin ekzakt "*trascende*") materies. Si? Nëpërmjet vendimeve që merr , nëpërmjet aftësisë programuese, nëpërmjet marrëdhënieve me të tjerët etj.
- Pra, qënia njerëzore nëpërmjet shpirtit njerëzor që është realitet shpirtëror shkon përtej përmasave të kohës e të vendit.
- Shpirti i njeriut është shpirtëror, pra jo material e dmth nuk është i përbërë nga pjesë materiale të ndryshme të cilat mund të prishen dhe të shpërbëhen.
- **SHPIRTI I NJERIUT NUK MUND TË VDESË SEPSE ËSHTË REALITET SHPIRTËROR.**
- SHPIRTI JO VETËM QË ËSHTË I PAVDEKSHËM, QË NUK VDES KURRË, POR NË FAKT AS NUK MUND TË VDESË.



# Trupi është realitet material, i vdekshëm dhe vdes...

Përkundrazi, trupi i njeriut duke qenë realitet material, në këtë botë e ka të mundur që të vdesë.

E ka të mundur, por Zoti, edhe pse e ka të mundur që të vdesë, nuk donte që të vdesë as trupi i njeriut. Pra, secili nga ne do të kishte patur nga Zoti dhuratën preternaturale të imunitetit ndaj vdekjes, sikurse në fakt e kishin Adami dhe Eva para mëkatit original.


Vdekja (e trupit) e njeriut ka hyrë në botë për shkak të mëkatit, pra ne vdesim, për shkak të mëkatit, sikurse shkruhet në Letrën drejtuar Romakëve, 5, 12; më saktësisht për shkak të mëkatit origjinal, të kryer nga progjenitorët tanë Adami dhe Eva dhe i transmetuar çdo anëtar i familjes njerëzore në çastin e ngjizjes.

Në po atë çast të futjes së shpirtit në zigo të (formimi i zigo tës, krijimi i shpirtit dhe infuzioni i shpirtit për t'u bërë një unitet me zigo tën ndodhin në të njëjtin çast), futet në ne, më saktë në shpirtin tonë, mëkati origjinal.

Pasoja të mëkatit origjinal janë sëmundja dhe vdekja e trupit.


**Atëhere, ne vdesim (trupi ynë vdes):**

- E para sepse mund të vdesë duke qenë realitet material dhe i përbërë nga pjesë që mund të prishen e shpërbëhen midis tyre
- E dyta, kjo ndodh realisht (edhe pse Zoti nuk e ka krijuar trupin që të vdesë) për shkak të trashëgimisë në shpirtin tonë të mëkatit origjinal



PRA,

# VDEKJA ËSHTË SHKËPUTJA E SHPIRTIT NGA TRUPI.



GJYQI



# Ku shkon shpirti kur shkëputet nga trupi?

Duke qenë se shpirti i njeriut është i pavdekshëm, kur shkëputet nga trupi duhet të shkojë diku. Atëhere ku shkon?

Së pari, për të besuar në këto realitete të gjërave të fundit të njeriut, që nuk mund të dihen me arsyen njerëzore, duhet t'i drejtohem fesë, ose më saktë akoma, duhet t'i drejtohem atij që këto realitete i njeh shumë mirë, që është Zoti.

- Pra, ne besojmë se ekzistojnë këto gjëra të fundit të njeriut sepse na i ka zbuluar vetë Jezu Krishti, që është Zot, pra na i ka zbuluar vetë Zoti. Këto quhen “të vërteta të zbuluara nga Zoti” dhe bëjnë pjesë në dogmat e Kishës Katolike: do të thotë që janë sigurisht të vërteta dhe nëq një njeri nuk i pranon si të vërteta, është anatema, pra jashtë Kishës katolike!

- **Shpirti i njeriut në çastin e vdekjes shkon ose në parajsë (direkt ose duke kaluar përpara nga Purgatori) ose në ferr.**

- Kjo do të thotë që shpirti për të shkuar në këto realitete, në çastin e vdekjes, pra kur shkëputet nga trupi, duhet të kalojë nëpër një gjyq.

- Shpirti i çdo qenieje njerëzore do t'i nënshtrohet dy gjyqeve: **gjyqi i veçantë dhe gjyqi universal**



# GJYQI I VEÇANTË

- *Çdo njeri që nga momenti i vdekjes së tij merr në shpirtin e tij të pavdekshëm shpërblimin e përjetshëm, në një **gjq të veçantë** që e vë jetën e tij në raport me Krishtin, dhe për këtë ose do të kalojë nëpërmjet një purifikimi, ose do të hyjë në lumturinë e amshuar të qiellit ose do të humbasë shpirtin menjëherë e përgjithmonë. (KKK 1022)*
- Mund ta shikojmë gjyqin e veçantë të çdo shpirti jo si një gjykim nga jashtë, por si një gjyq që ndodh brenda në ndërgjegjen e njeriut e cila ndriçohet plotësisht nga drita e pafund dhe e amshuar e Zotit, që i vendos para në mënyrë shumë të qartë njeriut të gjitha të mirat e të këqijat që ka bërë në jetë.
- Atëhere, termi «gjykata e Zotit» është më shumë një metaforë e përdorur nga jeta shoqërore e njeriut, pasi bilancimi ynë i brendshëm me efektet e tij është gjykimi ynë. Jeta e amshuar esencialisht është brenda nesh: secili nga ne mbart brenda vetes ferrin e vet ose qiellin (paraajsën) e vet.
- **Pra, gjykata është brenda nesh** dhe kjo gjykatë është ndërgjegja. por ndërgjegja që është zëri i Zotit, jo ndërgjegja e rreme, e cila është e formuar nga veset.
- Përsa i përket vendit ku ky gjyq do të bëhet, mund të themi që nuk bëhet fjalë për një vend material. Jeta e amshuar është në esencë një gjendje e njeriut (e shpirtit), jo një vend.



# GJYQI I VEÇANTË

- Gjyqi dhe si pasojë destinacioni i ndryshëm i atyre që bëjnë mirë dhe atyre që bëjnë keq jo vetëm që do të bëhet, jo vetëm që ekziston, por nuk ka se si të mos bëhet; është e pamundur pra që të mos ketë një gjyq për shpirtin! Këtë mund ta themi me siguri, nqs kemi parasysh një tjetër element të rëndësishëm dhe esencial, dallues për qenien njerëzore: liria.

Cdo qenie njerëzore është krijuar nga zoti e lirë, por liria e qenies njerëzore nuk është një liri absolute, por është liria e një krijese dhe ka dy limite: limitin e natyrës dhe limitin e qëllimit.

- Limiti i natyrës ka të bëjë me faktin që natyra njerëzore është një natyrë krijese, dmth nuk jemi ne që kemi vendosur që të vijmë në botë etj.

- Limiti i qëllimit ka të bëjë me faktin që ne nuk jemi të lirë nga të qenit të lumtur. Nuk është një imponim nga jashtë, por është një nevojë e brendshme dhe themelore e natyrës së shpirtit tonë dhe jetës sonë.

Pra, liria e njeriut ka të bëjë me ndërtimin e lumturisë së tij, ose më saktë akoma me ndërtimin e shenjtërisë së tij.

Mund të deduktojmë atëhere që çdo gjë që bëjmë që shkon kundër këtij qëllimi, këtij objektivi qendror dhe themelor, kundër së mirës së vërtetë që është Zoti, e ka në vetvete gjykimin e vet:

Njeriu, duke bërë keq, dmth duke keqpërdorur lirinë që Zoti ja ka dhënë për të bërë mirë, i bën keq vetes dhe dënon menjëherë vetveten.

Ne mund të pohojmë me Shën Gregorion: **Faji dhe dënimi i fajit nuk janë dy gjëra të ndryshme: por vetë faji i njeriut hidhet kundër njeriut.**

## KY ËSHTË GJYQI!

Themelet biblike të gjyqit të veçantë janë: Luka 16, 19-31, Luka 23, 43, Letra e dytë drejtuar Timoteut 4, 6, Letra drejtuar Hebrenjve 9, 27



# GJYQI UNIVERSAL

1. Gjyqi universal është ai gjyq që do të ndodhë në fund të botës.
2. Me gjyqin universal nuk preket dhe nuk ndryshohet aspak gjyqi i veçantë që çdo krijese ka marrë ose do të ketë marrë në çastin e vdekjes: ajo çka vendoset në gjyqin e veçantë është e vlefshme përgjithmonë!
3. Në gjyqin e veçantë nuk gjendet trupi, kurse në gjyqin universal do të kemi ringjalljen e trupit dhe trupi do të bashkohet me shpirtin e tij përkatës dhe duke qenë se i bashkohet shpirtit përkatës, edhe ai sikurse shpirti, merr shpërblimin e tij në të mirë ose në të keq, sipas "fatit" që ka patur shpirti.
4. Gjyqi i veçantë bëhet midis Zotit dhe njeriut (shpirtit të njeriut) në mënyrë individuale, kurse gjyqi universal do të bëhet përpara të gjithë qiellit.
5. Themelet biblike të këtij gjyqi i gjejmë në: Mateu 25; Letra e dytë drejtuar Korintasve 10; Letra drejtuar Romakëve 14, 10; Letra e dytë drejtuar Selanikasve kap 1-2.





*"Në mbrëmjen e jetës, do të gjykohe mi dashurinë".*

Shën Giovanni della Croce



FERRI

# FERRI

- Ne e dimë që ferri ekziston sepse Jezu Krishti Zot na ka thënë që ekziston.
- Themelet biblike: Mateu 5, 22; Mateu 13, 49- 50; Marku 9, 43-48; Mateu 10, 28; Mateu 13, 41-42; Mateu 25, 41; Mateu 7, 13-14; Mateu 5, 29

Marku 9, 43-48: *Prandaj, nëse dora jote të çon në mëkat, preje! Më mirë është për ty të hysh dorëcung në jetë se me të dy duart të shkosh në ferr - në zjarr që s'fiket kurrë. E nëse këmba jote të çon në mëkat, preje! Më mirë është për ty të hysh në jetë i çalë se t'i kesh të dy këmbët e të hidhesh në ferr. Po qe se edhe syri yt të çon në mëkat, nxirre! Më mirë është për ty të hysh në Mbretërinë e Hyjit me një sy se t'i kesh të dy e të hidhesh në ferr. Ku 'krimbi i tyre nuk cof e zjarri nuk fiket.*

- Jezusi përdor imazhin domethënës të krimbit për të simbolizuar “bregat e ndërgjegjes” që kanë shpirtat në ferr, që i gërryejnë shpirtin nga brenda, ashtu sikurse krimbi gërryen vazhdimisht drurin.
- Shkon në ferr ai shpirt njeriu që nuk ka veshur veshjen e dasmës, që është një simbol që e ka përdorur vetë Jezusi në Mateu 22, 1-14 dhe simbolizon hirin shenjtërues të Zotit. Pra, ai shpirt njeriu, që në momentin e vdekjes gjendet pa hirin shenjtërues të Zotit, shkon në ferr. Hiri shenjtërues i Zotit humbet nëpërmjet mëkatit të rëndë.
- Pra, “Shpirtat e atyre që vdesin në gjendje mëkati të rëndë, pas vdekjes zbresin menjëherë në ferr, ku pësojnë ndëshkimet e ferrit, “zjarrin që nuk shuhet kurrë” (KKK 1035).




SHKON NË FERR AI SHPIRT  
NJERIU QË VDES NË GJENDJE  
MËKATI TË RËNDË.



# FERRI

- Vuajtja nga fakti i pamundësisë për të dashur përbën thelbin, esencën e ferrit.
- Linja misterioze që ferrin nga parajsja kalon në çdo çast në zemrën e çdo njeriu. Pra, qielli dhe ferri janë që tani në ne.
- Megjithatë, ferri që jeton një njeri në këtë tokë që nuk është në hir, pra që është në gjendje mëkati të rëndë, nuk është sikurse ferri i “botës së përtejme”, dmth ferri pas vdekjes është shumë më i tmerrshëm dhe më i dhimbshëm!
- Në ferr të humburit vuajnë ndëshkimin e dëmit dhe ndëshkimin e shqisave.
- Ndëshkimi i dëmit është ndëshkimi që vjen nga dëmi kryesor që shpirti pëson duke përfunduar në ferr, i cili është përjashtimi përfundimtar dhe i përhershëm nga jeta e amshuar, nga parajsja, nga miqësia me Zotin.
- Ndëshkimi i shqisave është një vuajtje pak a shumë “fizike”, një vuajtje që shkaktohet kryesisht nga zjarri për të cilin flet Jezusi. Përsa i përket natyrës së zjarrit të ferrit, Shën Agustini thotë se zjarri ekziston, por se i cilës natyrë është nuk mund ta dimë me siguri nqs vetë Zoti nuk ja zbulon dikujt.
- Ferri është i përjetshëm, sepse duke qenë shpirtrat që gjenden në ferr të gjithë në gjendje mëkati të rëndë dhe duke qenë se mëkati i rëndë është një largim nga e Mira e Pambaruar (Zoti), ndëshkimi i këtij mëkati është po ashtu i pafund, i pambaruar.



# FERRI

- Shpirtrat e ferrit nuk mund të kthehen mbrapsht nga ferri sepse sapo të vdesim, dalim nga koha dhe futemi në amshim. Amshimi është një çast që nuk ka as të kaluar; as të ardhme pra nuk ka një çast tjetër në dispozicion për t'u penduar.. Prandaj nqs në çastin e vdekjes, shpirti gjendet në gjendje mëkati të rëndë, kështu do të gjendet përgjithmonë.
- **Zoti nuk çon asnjëri në ferr.** Përkundrazi, deri në çastin e fundit të jetës së çdo njeriu, Zoti bën të pamundurën për ta shpëtuar çdo njeri nga ferri, sikurse thuhet në Letrën e parë drejtuar Timoteut, 2, 3-4. Është vetë njeriu, që nëpërmjet mëkatis të rëndë, pa u penduar as edhe në çastin e fundit të jetës, largohet përfundimisht nga Zoti, pra shkon në ferr.
- Ferrin nuk e ka krijuar Zoti, por Luciferi dhe engjëjt rebelë (djajtë) në çastin në të cilin ata kanë refuzuar Zotin.
- Zoti lejon që shpirtrat të shkojnë në ferr, sepse Zoti është dashuri dhe do të mikpritet lirisht nga krijesa e tij, që është po ashtu e lirë për ta dashur Atë apo jo. Zoti nuk detyron askënd që ta dojë.
- Disa thonë që ferri ekziston, por është bosh. Fatkeqësisht, ferri nuk është bosh. Për të pohuar këtë mbështetemi gjithnjë tek fjalët e Jezusit në Luka 13, 23-24.
- **Ferri është një gjendje e shpirtit.** Por, fakti që ferri është esencialisht dhe sigurisht një gjendje e shpirtit, nuk përjashton faktin që ferri mund të jetë edhe një vend.
- Nuk është e shkruar se kush shkon në ferr, por një njeri, duke zgjedhur lirisht dhe vazhdimisht, deri në castin e fundit të jetës, që të refuzojë Zotin nëpërmjet mëkatis të rëndë, pa u penduar fare, vetë ndëshkohet (shkon në ferr).





PARAJSA

# PARAJSA

- Parajsa ekziston dhe ne e dimë që ekziston sepse Jezu Krishti na e ka zbuluar që ekziston.
- Në Luka 23, 40-43 vetë Jezu Krishti e përmend Parajsën duke përdorur terminologjinë Parajsë. Ka edhe shumë pjesë të tjera biblike ku flitet për Parajsën, si në Dhjatën e Vjetër ashtu edhe të Re, por jo përherë përmendet me këtë fjalë Parajsë por me fjalë të tjera.
- Qielli ose Parajsa nuk janë diçka abstrakte dhe nuk janë as edhe ndonjë vend atje midis reve, por është një marrëdhënie e gjallë dhe personale me Trininë e Shenjtë. është takimi me Atin që realizohet në Krishtin e Ringjallur falë bashkimit të Shpirtit të Shentj. (Shën Gjon Pali II, 21 korrik 1999)
- **Shkon në parajsë ai shpirt që vdes në gjendje hiri!**

Por, për tu futur në Parajsë nuk mjafton vetëm hiri shenjtërues i Zotit, I cili është i nevojshëm dhe I domosdoshëm në çdo rast, pra që të mos jemi në gjendje mëkati të rëndë, por duhet të jemi të pastruar edhe nga mëkatet jo të rënda, të ashtuquajtuara veniale, si edhe nga dëmet dhe pasojat e mëkateve tonaa, sepse "në Jeruzalemin qiellor nuk do të hyjë asgjë që nuk është e pastër". (Zbulesa 21, 27)



# *Ishin të veshur me petka të bardha e me palma në dorë...*


Asnjëri prej nesh nuk mund të futet në Parajsë e para pa veshjen e bardhë si bora, dmth pa i pasë larë të gjitha njollat e mëkateve e të dëmit që vjen nga ato,

E dyta pa palmën, dmth pa dashurinë e Zotit, që mund të shprehet në shumë forma, jo modeomos në derdhjen e gjakut si martirët, sikurse na thotë Gjoni në Zbulesa 7, 9-14



# PARAJSA

- Parajsa më shumë se sa një vend, është një gjendje, një gjendje në të cilën shpirti është i bashkuar në mënyrë perfekte me Krijuesin e tij, dmth me Zotin.
- Për të parë (dhe shijuar) Parajsën e botës së përtejme duhet që të vdesim, pra duhet që shpirti të shkëputet nga trupi ynë material dhe të “pajiset” me “*lumen gloriae*” që do të thotë “drita e lavdisë”, e cila është një dritë e veçantë që Zoti ja jep shpirtit i cili është në gjendje hiri për ta bërë të mundur që shpirti të mund të shohë dhe kështu të shijojë atë që quhet vizioni i lumë, pra ta bëjë të aftë shpirtin të shikojë Zotin në fytyrë. Kurse në këtë jetë, nuk mund ta shikojmë Zotin në këtë mënyrë, por vetëm nëpërmjet asaj që quhet “*lumen fidei*” pra drita e fesë.
- Parajsa është Zoti (marrëdhënia intime me të) dhe Zoti është i pambaruar, pra s’ka as fillim, as fund, e kështu edhe të qenit e të shijuarit tonë në Parajsë nuk do të ketë kurrë fund!



# PARAJSA

- Në Parajsë do të vazhdojmë të jemi krijesa njerëzore. Nuk e humbasin natyrën tonë njerëzore, nuk shndërrohemi në engjëj.
- Në Parajsë, në gjykimin universal, shpirtit do t'i bashkohet edhe trupi i tij përkatës, por do të jetë një trup shpirtëror, i ashtuquajtur trup i lavdishëm. Trupat e ringjallur do të jenë të gjithë perfekt, të pakorruptueshëm dhe si trupa të moshës 33 vjeçare, që është moshë perfekte. Duke qenë në amshim, nuk do të kemi moshë.
- Në Parajsë do t'i njohim e do t'i duam edhe më shumë të dashurit tanë në tokë që gjenden në Parajsë me ne. Parajsa është marrëdhënie dashurie e pafund me Zotin, por edhe me shenjtërit e tij (dmth me secilin njeri që gjendet në Parajsë). Aq më shumë do të jetë marrëdhënie dashurie perfekte dhe e pafund me ata që ne kemi dashur më shumë në këtë tokë.



# PARAJSA

- Në Parajsë ka dy lloje lavdish (lavdi është e mira/ lumturia që gëzohet në Parajsë): lavdia esenciale dhe lavdia aksidentale.
- Lavdinë esenciale e kanë të gjithë ata që gjenden në Parajsë dhe është kryesorja dhe themelorja, që është pra të shikuarit e Zotit në fytyrë, ose vizioni i lumë.
- Lavdia aksidentale: Në Parajsë do të kemi edhe lavdinë aksidentale, që është ajo lavdi që vjen nga të paturit e të shijuarit e asaj që nuk identifikohet me Zotin.

Kjo lavdi vjen nga shpërblimi që Zoti do t'i japë secilit për meritat e tij; merita që janë fituar nëpërmjet sakrificave, lutjeve, vuajtjeve, veprave të mira etj.

Futet në këtë lavdi edhe të paturit e shoqërisë së shenjtërve dhe engjëjve. Së pari, do të kemi shoqërinë e Zojës Mari.

Në Parajsë do të na plotësohet çdo dëshirë, çdo qejf.

Në Parajsë nuk do të ketë më as trishtim, as lotë, as vuajtje, as dhimbje, as frikë, as pasiguri për jetën.

Duke qenë se lavdia esenciale, lumturia e Parajsës është esencialisht marrëdhënia e dashurisë dhe intimitetit, miqësisë me Zotin, dhe kjo në vetvete është e mjaftueshme për lumturinë tonë të amshuar, atëherë ne mund të jemi të lumtur edhe pa asnjë krijesë afër, nesh, edhe vetëm me Zotin, kushdo qoftë kjo krijesë



# PURGATORI

# PURGATORI

- Protestantët thonë që Purgatori nuk ekziston, sepse, sipas atyre, Jezusi nuk ka folur askund në Bibël për purgatorin. Është e vërtetë që nuk folur për Purgatorin në Bibël... haptas! Dmth, nuk e ka quajtur me emrin që e quajmë tani Purgator, por në fakt ka shumë pjesë biblike, si të Dhjatës së Re ashtu edhe të Vjetër, që na e zbulojnë dhe na e pohojnë ekzistencën e Purgatorit.
- Purgatori quhet i tillë, sepse vjen nga fjala latinisht “purgare” që do të thotë të pastrosh, të lirosh diçka nga të gjitha papastërtitë.
- Në Mateu 12, 31-32 dhe në letrën e parë drejtuar Korintasve 3, 10-15 flitet respektivisht për një realitet në të cilin disa mëkate falen (ato jo të rënda) e disa jo (ato të rënda) dhe gjithashtu në të cilin disa shpirta shëlbohen (pra nuk shkojnë në ferr) por pastrohen si nëpërmjet zjarrit (pra nuk shkojnë as direkt në Parajsë). Këtë realitet teologët e quajnë Purgator.
- Purgatori është një realitet i botës së përtejme, së ardhme, që është efekt i Mëshirës Hyjnore për të gjithë shpirtat, që vdesin në gjendje hiri, por nuk janë të pastruar tërësisht prandaj nuk mund të futen menjëherë në Parajsë.
- Shkon në Purgator ai shpirt njeriu që në çastin e vdekjes gjendet në hirin shenjtërues të Zotit, dmth nuk është në gjendje mëkati të rëndë, por ka akoma mëkate jo të rënda për të pastruar e/o dëme që rrjedhin nga mëkatet e bëra në jetë.
- Ai shpirt njeriu që gjendet në Purgator, pasi të përfundojë pastrimin e tij të plotë, dmth Purgatorin e tij, është e sigurtë dhe e garantuar që shkon në Parajsë.



# PURGATORI

- Shpirtrat e Purgatorit pastrohen nga mëkatet jo të rënda për të cilat nuk janë penduar, ose nga mëkatet e rënda për të cilat janë penduar por jo pastruar tërësisht, nga dëmet që rrjedhin nga këto mëkate, nga lidhjet e çrregullta me gjërat e kësaj bote nëpërmjet zjarrit, pak a shumë sikur pastrohet hekuri në zjarr nga ndryshku. Nuk dihet mirë nëse në këtë rast zjarri është i vërtetë si zjarri i ferrit, apo është një simbol që përdoret për të treguar thellësinë e pastrimit që bëhet në Purgator.
- Jemi të sigurtë që Purgatori është një gjendje e shpirtit, por përse i përket vendit të Purgatorit nuk ka asgjë të thënë haptas në Bibël e kështu që nuk mund ta zgjidhim këtë çështje.
- **Shpirtrat e Purgatorit gjenden në pamundësinë për t'u lutur për veten apo për dikë tjetër dhe kanë nevojë për lutje**
- Shpirtrat e Purgatorit me të vërtetë nuk mund të luten për ne drejtpërdrejtë por mund t'i ofrojnë Zotit veprat dhe lutjet e tyre.





## LUTUNI PËR SHPIRTRAT E PURGATORIT!

Do t'i ndihmoni ata, dhe sa më shumë t'i ndihmoni, aq më shumë do t'ju ndihmojnë ata juve!

# PURGATORI

Ndihma e parë dhe më e madhe që mund t'u japim shpirtave të Purgatorit është që të ofrojmë Meshën e shenjtë për ta. Sa më shumë të kemi mundësi, aq më mirë është. Është e këshillueshme, paktën për një shpirt të një vdekuri tanë të dashur, të ofrojmë Meshat gregoriane. Janë 30 mesha rresht që thuhet për shpirtin e të njëjtit person, pa ndërprerje.



# PURGATORI

- Gjithashtu, mund të ofrojmë për shpirtrat e Purgatorit indulgjencat (faljet) që janë heqja (falja) e dënimit të përkohshëm që vjen nga mëkatet, për të cilat jemi penduar e rrëfyer, pra janë të falura përsa i përket fajit.
- Ne mund t'i marrim indulgjencat për veten tonë ose për një ose disa shpirtra të vdekurish, që gjenden në Purgator. Nuk mund ta marrim për një të gjallë tjetër!
- Kisha e ka fuqinë për të përcaktuar këto falje sepse këtë pushtet për të zgjidhur e për të lidhur ja ka dhënë Jezu Krishti (në Mateu 16:19) Po ashtu, këtë gjë Kisha mund ta bëjë falë realitetit të Korpit Mistik të Krishtit (Kisha është Korpi Mistik) dhe falë realitetit të bashkësisë së shenjtërve.

*Ekzistojnë dy lloj indulgjencash (faljesh): e plotë ose e pjesshme.*

- Falja e pjesshme na jep faljen e pjesshme pra vetëm të një pjese të dënimit të përkohshëm që vjen nga mëkatet e falura nga rrëfimi.
- Falja e plotë na jep faljen e plotë të dënimit të përkohshëm që vjen nga mëkatet e falura nga rrëfimi (përsa i përket fajit).

*Kriteret që duhet të plotësojmë për të marrë faljen (indulgjencën) e plotë janë:*

1. Kungimi sakramental në atë ditë që merret indulgjenca (me një Kungim merret vetëm një falje e plotë)
2. Rrëfimi 8 /15 ditë para ose pas kësaj dite që merret indulgjenca (me një rrëfim merren shumë falje të plota)
3. Lutja sipas njetit të Atit të Shenjtë (zakonisht 1 Ati ynë, 1 Të Falemi Mari, 1 Lavdi Atit)
4. Vepra e indulgjencuar
5. Shkëputje e plotë nga lidhja me çdo lloj mëkati, qoftë edhe më i vogli



# PURGATORI

Kuptohet atëhere pse falja e plotë është shumë e vështirë për t'u marrë me një indulgjencë të vetme: sepse për secilin prej nesh është e vështirë shkëputja nga çdo lloj mëkati, edhe më i vogli.

**Këshillë:** *Mos u mjaftoni vetëm me një apo dy indulgjenca (falje) të plota, por për arsyet që thamë më sipër, merrni sa më shumë indulgjenca, sa herë ta keni të mundur!*

Indulgjenca e plotë nuk merret vetëm në ditë të veçanta që I cakton Kisha, por mund të merret edhe përditë (maksimumi një herë në ditë), nëq ne arrijmë të plotësojmë përditë 5 kriteret e sipërpërmendura.



# PURGATORI

Disa nga veprat e indulgjenciuara janë:

- Adhurimi eukaristik për të paktën 30 minuta
- Lutja e Rruzares në kishë, në familje ose në komunitet
- Udha e Kryqit
- Leximi i Shkrimit të Shenjtë për të paktën 30 minuta
- Vizita e një kishe më 1 nëntori në mesditë deri më 2 nëntor në mesnatë për të vdekurit
- Vizita e varrezave në një nga këto ditë: nga 1 nëntori deri më 8 nëntor (përfshi data 1 dhe 8), vetëm për të vdekurit
- Pjesëmarrja në një ceremoni solemne të Kungimit të parë të një personi ose të Meshës së parë të një prifti ose të 25/ 50/ 60 përvjetorit të shugurimit priftëror të një prifti
- Rinovimi i premtimeve të Pagëzimit gjatë vigjiljes së Pashkëve
- Adhurimi i Kryqit gjatë ceremonisë solemne në të premtën e Madhe
- Bekimi i Papës i marrë edhe duke e dëgjuar në radio ose në televizor
- Në çastin e vdekjes, mund të jepet nga një prift, ose duke puthur Kryqin (por personi që po vdes duhet të ketë thënë ndonjë lutje gjatë jetës).





**Faleminderit!**  
**I gjeni të shkruara në sitin:**  
**[www.beatoalano.it/al](http://www.beatoalano.it/al)**